



## Economic impact of COVID-19 pandemic toward the women's entrepreneurship

April, 2020

WE EFFECT



NETWORK OF ORGANIZATIONS  
FOR RURAL DEVELOPMENT OF KOSOVO

### Hyrje:

Pandemia COVID-19 po vazhdon të rritet në një shkallë të pamatshme në nivel global, ndërsa ne na mbetet për të parë ndikimin e paevitueshëm që do të lërë pandemia, që për shkak të mbylljeve shtetërore dhe mbarëkombëtare, distancimit shoqëror, mbylljes së bizneseve të panumërta, dhe kalimit të punës në distancë për miliona njerëz në të gjithë botën, tanimë ka filluar të dëshmohet ndikimi i saj në ekonominë globale.<sup>1</sup>

Historia tregon se në raste të pandemive të tilla, pabarazia gjinore është edhe më e theksuar, prandaj është e rëndësishme që masat e marra kundër pandemisë të kenë në konsideratë edhe adresimin gjinor duke shmangur përkeqësimin e mëtutjeshëm të situatës.<sup>2</sup>

Dëshmi të reja mbi ndikimin e COVID-19 sugjerojnë që sfera ekonomike e grave do të preket në mënyrë disproporcionale nga ajo e burrave, sepse në të gjithë globin, gratë fitojnë më pak, mbajnë punë më pak të sigurta dhe kanë më shumë të ngjarë të punësohen në sektorin informal.<sup>3</sup> Gjithashtu, ato kanë më pak çasje në mbrojtje sociale dhe përbëjnë shumicën e familjeve me një prind, duke rezultuar në një aftësi më të ulët të tyre për të përvetësuar këto lloje të tronditjeve ekonomike në krahasim me burrat.

Sipas Organizatës Ndërkombëtare të Punës, në të gjithë botën, gratë përfaqësojnë më pak se 40% të punësimit total, por përbëjnë 57% të atyre që punojnë me kohë të pjesshme.<sup>4</sup> Prandaj, ndërsa efektet e pandemisë COVID-19 përshkojnë ekonomitë, duke zvogëluar mundësitë e punësimit dhe duke shkaktuar largime nga puna, punëtorët e përkohshëm, shumica e të cilëve janë gra, pritët të mbajnë barrën më të rëndë të humbjeve të vendeve të punës.

<sup>1</sup> Chamber B., ForbesWomen. Mars 2020. How women entrepreneurs are navigating the effects of COVID-19, e disponueshme në: <https://www.forbes.com/sites/brittanychambers/2020/03/26/how-women-entrepreneurs-are-navigating-the-effects-of-covid-19/#5820d18a246d>

<sup>2</sup> Wenham C., Smith J., Morgan R. (2020). COVID-19: the gendered impacts of the outbreak, e disponueshme në: [https://www.thelancet.com/journals/lancet/article/PIIS0140-6736\(20\)30526-2/fulltext](https://www.thelancet.com/journals/lancet/article/PIIS0140-6736(20)30526-2/fulltext)

<sup>3</sup> United Nation. April 2020. Policy Brief: The Impact of COVID-19 on Women. e disponueshme në: [https://www.un.org/sites/un2.un.org/files/policy\\_brief\\_on\\_covid\\_impact\\_on\\_women\\_9\\_april\\_2020.pdf](https://www.un.org/sites/un2.un.org/files/policy_brief_on_covid_impact_on_women_9_april_2020.pdf)

<sup>4</sup> Durant I., Coke-Hamilton P. UNCTAD 2020.COVID- 19 requires gender- equal responses to save economies, e disponueshme në: <https://unctad.org/en/pages/newsdetails.aspx?OriginalVersionID=2319>

## COVID- 19 dhe bizneset:

Sipërmarrësit e biznesit, në veçanti, janë një nga popullatat që janë prekur shumë ekonomikisht nga pandemia COVID-19.<sup>5</sup>

Sipërmarrëset gra do të ndiejnë tronditjen e ardhshme më shumë sesa shumica e faktorëve: ato kanë tendencë të drejtojnë biznese

më të vogla, janë më pak të kapitalizuar dhe janë përqendruar shumë në sektorin e shërbimeve - një sektor më i ndikuar nga kufizimet e COVID. Në nivel global, bizneset e sipërmarrësve në industri me rrezik të menjëhershëm, 39% janë në pronësi të grave, ose në pronësi të grave dhe burrave, në krahasim me 29% të bizneseve në industri me rrezik afat-mesëm dhe 36% me rrezik afatgjatë.<sup>6</sup>



Prandaj, pse gratë janë më të rrezikuara nga tronditjet ekonomike të bëra nga krizat siç është pandemia COVID-19?

### ➔ Puna e papaguar

Një hulumtim i studiuesve në Universitetin Northwestern, Universiteti i Mannheim në Gjermani dhe Universiteti i Kalifornisë, ka nxjerrë si përfundimin se "pandemia COVID-19 do të ketë një efekt disproporcional negativ tek gratë dhe mundësitë e tyre të punësimit".<sup>7</sup> Masat për të parandaluar pandeminë siç janë karantinat dhe mbyllja e shkollave nënkuptojnë punë shtesë dhe përgjegjësi të familjes për gratë. Ndërsa kërkesat janë më të mëdha për kujdes në shtëpi, punët e tyre gjithashtu do të preken në mënyrë disproporcionale nga shkurtimet dhe pushimet nga puna.

### ➔ Rrjete sigurie jo mjaft të gjera

Shumë gra nuk do të përfitojnë nga rrjeti i sigurimeve shoqërore pasi qasja në to varet shpesh nga pjesëmarrja zyrtare në forcën e punës apo punësimi formal. Por, meqenëse gratë kanë tendencë të punojnë pa kushte të qarta të punësimit, ato shpesh nuk kanë të drejtë në mbrojtje të besueshme sociale, siç janë sigurimi shëndetësor, pagesat në rast të sëmundjeve dhe pushimi i lehonisë, pensionet

<sup>5</sup> Chamber B., ForbesWomen. Mars 2020. How women entrepreneurs are navigating the effects of COVID-19, e disponueshme në: <https://www.forbes.com/sites/brittanychambers/2020/03/26/how-women-entrepreneurs-are-navigating-the-effects-of-covid-19/#5820d18a246d>

<sup>6</sup> Liu S., Parilla J., The Brookings Institution 2020. Businesses owned by women and minorities have grown. Will COVID-19 undo that?, e disponueshme në: <https://www.brookings.edu/research/businesses-owned-by-women-and-minorities-have-grown-will-covid-19-undo-that/>

<sup>7</sup> Hutzler A., Newsweek 2020. The economic impact of coronavirus on women is 'devastating' and exacerbating gender equality, e disponueshme në: <https://www.newsweek.com/economic-impact-coronavirus-women-devastating-exacerbating-gender-inequality-says-1497325>

dhe përfitimet e papunësisë.<sup>8</sup> Ndërsa në shumë vende në zhvillim, gratë janë ose të vetëpunësuar ose punojnë si punëtores kontribuese të familjes, për shembull në fermat familjare.

### **Prekja e sektorit të shërbimit**

Sektori i shërbimeve po goditet shumë nga kufizimet e vendosura për të menaxhuar përhapjen e pandemisë COVID-19.

Duke pasur parasysh që rreth 55% e grave janë të punësuar në këtë sektor (në krahasim me 44% të burrave), gratë kanë më shumë të ngjarë të preken negativisht.<sup>9</sup>



### **Qasje e kufizuar në kredi**

Gratë sipërmarrëse shpesh janë të diskriminuara kur përpiqen të kenë qasje në kredi dhe kjo mund të jetë një sfidë pasi kredia do të ketë një rëndësi të madhe për mbijetesën e bizneseve. Pa linja kredie të hapura dhe të favorshme, shumë sipërmarrëse femra do të detyrohen të mbyllin bizneset e tyre.<sup>10</sup>

Në përgjithësi, ekziston mungesa e disponueshmërisë së shërbimeve financiare për gratë në zonat rurale, por edhe ato ekzistuese të destinuara për komunitetet rurale rrallë u sjellin dobi grave rurale. Kjo sepse në të njëjtën kohë, institucionet financiare përballen gjithashtu me kufizime gjatë shtrirjes së shërbimeve për gratë rurale, pjesërisht për shkak të mungesës së mirëkuptimit të përgjithshëm të sektorit rural dhe bujqësor, përfshirë dinamikën gjinore.<sup>11</sup>

### **Situata e bizneseve në Kosovë:**

Numri i ndërmarrjeve aktive në sektorët ekonomikë nga raporti i Bankës Botërore në Kosovë gjatë vitit 2018, bazuar në kriteret e deklaramit, ishte 35540.<sup>12</sup> Për sa i përket sektorëve ekonomikë, numri më i madh i ndërmarrjeve i takon tregtisë me 16143 ndërmarrje ose të shprehura në përqindje (45.4%), shërbimet e biznesit me 5250 (14.8%) dhe përqindja tjetër në sektorë të tjerë, duke krijuar rreth 60349 të punësuar ose shprehur në përqindje (33.9%).<sup>13</sup> Punësimi më i lartë është tek burrat 46.2%, ndërsa

<sup>8</sup> Durant I., Coke-Hamilton P. UNCTAD 2020.COVID- 19 requires gender- equal responses to save economies, e disponueshme në: <https://unctad.org/en/pages/newsdetails.aspx?OriginalVersionID=2319>

<sup>9</sup> MOH International 2020. COVID-19 requires gender- equal responses to save economies, e disponueshme në: <http://www.moh.international/blog/2020/4/5/covid-19-requires-gender-equal-responses-to-save-economies>

<sup>10</sup> International Labour Organization. 2020. COVID- 19 and the world of work: Impact and policy response, e disponueshme në: [https://www.ilo.org/wcmsp5/groups/public/---dgreports/--dcomm/documents/briefingnote/wcms\\_738753.pdf](https://www.ilo.org/wcmsp5/groups/public/---dgreports/--dcomm/documents/briefingnote/wcms_738753.pdf)

<sup>11</sup> Organizata Botërore e Ushqimit dhe Bujqësisë e Kombeve të Bashkuara 2019. Women's access to rural finance: challenges and opportunities, e disponueshme në: <http://www.fao.org/3/ca5167en/CA5167EN.pdf>

<sup>12</sup> World Bank in Kosovo. Small, informal enterprises in Kosovo 2019, e disponueshme në:[http://siteresources.worldbank.org/KOSOVOEXTN/Resources/297769-1266424306995/Kos\\_key\\_devpnm.pdf](http://siteresources.worldbank.org/KOSOVOEXTN/Resources/297769-1266424306995/Kos_key_devpnm.pdf)

<sup>13</sup> Ministria e Financave dhe Transfereve Quarterly Economic Buletini Tetor-Dhjetor, 2019, e disponueshme në: <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/6737141D-43C4-4A55-A792-C5B8D214673F.pdf>

punësimi midis grave është 13.9%<sup>14</sup> dhe rrjedhimisht shkalla e papunësisë i bie të jetë 12.4% më e lartë tek gratë në krahasim me burrat.

### **Situata aktuale e COVID-19:**

Përhapja e pandemisë COVID-19 ka penguar prodhimin dhe ka çuar në një rënie të aktivitetit ekonomik në tre kategori: për qytetarët, komunitetin e biznesit dhe buxhetin e shtetit. Më 11 Mars 2020, Qeveria e Republikës së Kosovës miratoi masat e para parandaluese të përkohshme për të parandaluar përhapjen e kësaj pandemie në vend. Masat e marra nga qeveria për të luftuar pandeminë konsistojnë, ndër të tjera, kufizim të lëvizjes për të gjithë qytetarët, pezullimin e të gjithë transportit publik ndërqytetar në Kosovë, rritjen ose dyfishimin e sasisë së ndihmës sociale dhe pensioneve për disa kategori, mbështetje për sektorin privat dhe mbështetje për punëtorët e ekspozuar gjatë punës në terren.<sup>15</sup> Por, këto masa nuk kanë marrë parasysh implikimet gjinore të situatës së krijuar nga COVID-19, dhe ato që pritet të krijohen.

Ndërkohë në kuadër të paketës ekonomike të masave emergjente të përgatitura nga Ministria e Financave, pas përhapjes së pandemisë është përgatitur një raport për gjendjen e ekonomisë me shumë totale prej 170.6 milion euro.<sup>16</sup>

Duke pasur parasysh që Kosova ishte një nga vendet e fundit të prekura nga ky virus, ajo kishte më shumë mundësi për të parashikuar rreziqet minimale sociale dhe ekonomike, veçanërisht rreziqet për gratë dhe vajzat. Sidoqoftë, Rrjeti i Organizatave për Zhvillimin Rural të Kosovës nuk ka gjetur prova se qeveria ka kryer ndonjë vlerësim të ndikimit gjinor, pavarësisht nga fakti se Qeveria e Kosovës, në bazë të Ligjit për Barazi Gjinore, duhet të kryejë vlerësime të ndikimit gjinor për të marrë të gjitha politikat dhe veprimet e nevojshme në drejtim të parandalimit dhe eliminimit të diskriminimit gjinor.<sup>17</sup>

Si rezultat i mbylljes së përkohshme të shumë veprimtarive ekonomike, gratë dhe nënat beqare që mbajnë barrën e përgjegjësisë të kujdesit, përfshirë punët e shtëpisë, janë më të ekspozuara ndaj

---

<sup>14</sup> Agjencia e Statistikave të Kosovës. Anketa e Fuqisë Punëtoe 2019, e disponueshme në: <https://ask.rks.gov.net/media/5369/anketa-e-fuqis%C3%AB-pun%C3%ABtore-afp-2019.pdf>

<sup>15</sup> Qeveria e Kosovës ka krijuar një Komision të posaçëm për parandalimin e pandemisë COVID-19, Mars 2020, e disponueshme në: <https://kryeministri-ks.net/qeveria-e-kosoves-ka-themeluar-komisionin-e-posacem-per-parandalimin-e-corona-virusit/>

<sup>16</sup> Zyra e kryeministrit. Takimi i 19-të i Qeverisë - Paketa e Urgjencës Fiskale është miratuar, e disponueshme në: <https://kryeministri-ks.net/miratohet-pakoja-emergjente-fiskale/>

<sup>17</sup> Law on Gender Equality, Article 5, Paragraph 1, e disponueshme në: [https://equineteurope.org/wp-content/uploads/2019/10/Annex-LAW\\_NO.05\\_L-020\\_ON\\_GENDER\\_EQUALITY.pdf](https://equineteurope.org/wp-content/uploads/2019/10/Annex-LAW_NO.05_L-020_ON_GENDER_EQUALITY.pdf)

rreziqeve të shkeljes së të drejtave, veçanërisht nga sektori privat. Gratë e punësuar në sektorin privat në Kosovë shpesh punojnë në ekonominë joformale, dhe sipas Programit të Reformës në Ekonomi 2020-2022 të Qeverisë së Kosovës, vlerësohet se shtrirja e ekonomisë informale në Kosovë është mbi 30% e PBB-së me humbje të konsiderueshme për taksat kryesore direkte dhe indirekte.<sup>18</sup> Pa masat e duhura parandaluese, kjo i bën gratë më të prekshme ndaj ekspozimit financiar ndaj virusit, pasi gratë në këtë sektor punojnë pa kontratë dhe nuk mund të përfitojnë nga sigurimet shoqërore.

Në anën tjetër raportohet se ato vuajnë gjithashtu nga orët jashtë orarit të punës pa pagë shtesë. Edhe në kushte normale, përgjegjësitë e kujdesit për fëmijë dhe të moshuar zakonisht bien mbi gratë, për shkak të stereotipeve tradicionale sociale që lidhen me kujdesin. Me mbylljen e shkollave dhe vendeve të punës, barra e punës së papaguar të grave është rritur.<sup>19</sup> Edhe pse burrat, veçanërisht të moshuarit, statistikisht kanë më shumë të ngjarë të pësojnë vdekje sesa gratë nga COVID-19,<sup>20</sup> barra e madhe e kujdesit i ekspozon gratë dhe vajzat në pasoja të tjera.

Komisioni Special për Parandalimin e Përhapjes së COVID-19 dhe ai i Grupit Ndërinstitucional për Menaxhimin e Incidenteve në Kosovë ka përfshirë pjesëmarrje minimale të grave, konkretisht vetëm tri prej tyre në krahasim me pjesëmarrjen e burrave prej trembëdhjetë sosh. Për më tepër, pak gra udhëheqëse shihen në media dhe deklarata publike; duket se trajtimi i situatës në Kosovë në aspektin gjinor po trajtohet nga burrat dhe atë nga një këndvështrim aspak gjinor.<sup>21</sup>

Përfaqësimi jo i barabartë i grave në proceset e vendimmarrjes tutje mund të kontribuojë në krijimin e politikave të verbra gjinore.<sup>22</sup> Mos pjesëmarrja e grave në hartimin e politikave që prekin vetë ato në situata epidemike do të thotë që nevojat e grave mund të mos identifikohen dhe adresohen siç duhet.

---

<sup>18</sup> Qeveria e Kosovës. Programi I Reformës Ekonomike 2020-2022, e disponueshme në: <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/A92C6CA3-928C-41F3-9DA1-63E0D8CE5701.pdf>

<sup>19</sup> Kosovo Women's Network. Addressing COVID-19 from a Gender Perspective Recommendations to the Government of Kosovo e disponueshme në [https://womensnetwork.org/wp-content/uploads/2020/04/Addressing-COVID-19-from-a-Gender-Perspective\\_04\\_04\\_2020.pdf](https://womensnetwork.org/wp-content/uploads/2020/04/Addressing-COVID-19-from-a-Gender-Perspective_04_04_2020.pdf)

<sup>20</sup> Care International, The Gender Implications of Covid-19 outbreaks in development and humanitarian settings, 2020, e disponueshme në: [https://www.care.org/sites/default/files/gendered\\_implications\\_of\\_covid-19\\_full\\_paper.pdf](https://www.care.org/sites/default/files/gendered_implications_of_covid-19_full_paper.pdf)

<sup>21</sup> Kosovo Women's Network. Addressing COVID-19 from a Gender Perspective Recommendations to the Government of Kosovo, e disponueshme në: [https://womensnetwork.org/wp-content/uploads/2020/04/Addressing-COVID-19-from-a-Gender-Perspective\\_04\\_04\\_2020.pdf](https://womensnetwork.org/wp-content/uploads/2020/04/Addressing-COVID-19-from-a-Gender-Perspective_04_04_2020.pdf)

<sup>22</sup> Kosovo Women's Network. Addressing COVID-19 from a Gender Perspective Recommendations to the Government of Kosovo, e disponueshme në: [https://womensnetwork.org/wp-content/uploads/2020/04/Addressing-COVID-19-from-a-Gender-Perspective\\_04\\_04\\_2020.pdf](https://womensnetwork.org/wp-content/uploads/2020/04/Addressing-COVID-19-from-a-Gender-Perspective_04_04_2020.pdf)



## Rekomandime

Pandemia COVID- 19 paraqet një mundësi për të realizuar ndryshime sistematike që mund të mbrojnë gratë të mos mbajnë barrën më të rëndë të goditjeve si këto në të ardhmen. Kështu që, ne konsiderojmë që mundësitë e arsimit dhe aftësimin për gratë duhet të përmirësohen, në mënyrë që të lehtësohet zhvendosja nga punët e pasigurta në punë më të qëndrueshme dhe më të mbrojtura. Sigurimi më i gjerë i shërbimeve sociale do të heqë barrën e kujdesit për gratë dhe do t'u jepte atyre më shumë kohë për punë të paguar dhe kohë të lirë. Gjithashtu, marrëveshjet fleksibile të punës, të vendosura aktualisht në përgjigje të pandemisë, duhet të vazhdojnë përtej saj dhe të ofrojnë një model të ri të përgjegjësive të përbashkëta brenda familjeve. Për këtë arsye

### r e k o m a n d o j m ë:

✚ **Implementimi i analizës gjithëpërfshirëse gjinore** për të informuar dhe udhëhequr masat e mëtutjeshme të qeverisë. Planet strategjike dhe masat parandaluese kundër COVID-19 duhet të bazohen në analizën gjinore dhe të kenë vlerësimin e integruar të ndikimit gjinor në përputhje me Ligjin për Barazi Gjinore dhe legjislacionin ndërkombëtar. Kjo bazohet në stereotipet gjinore, rolet gjinore, ndarjen e pabarabartë të përgjegjësive të kujdesit midis grave dhe burrave, dhe dinamika të tjera që lindin si rezultat i këtyre të fundit.

✚ **Përfshirja e grave në hartimin e planeve dhe politikave** për të përballuar virusin COVID-19 dhe në propozimin e masave afatshkurtra ose afatgjata, veçanërisht në drejtim të mbrojtjes sociale, shëndetit dhe dhunës me bazë gjinore.

✚ **Masat speciale dhe përpjekjet e vazhdueshme** duhet të ndërmerren për të identifikuar shkeljet e të drejtave nga sektori i ekonomisë joformale, duke adresuar nevojat e grave që përbëjnë një pjesë dërrmuese të këtij sektori, në mënyrë që të përfshijnë këtë kategori në grupin e përfutësve të skemave të mbështetjes financiare për sektorin privat.

### **Të monitorohet shkelja e të drejtave të punës në sektorin privat, veçanërisht në sektorët**

thelbësor të përfaqësuar nga gratë, si rezultat i orarit të zgjatur të punës pa pagesa shtesë. Dhe, gjithashtu, për të njohur punën e papaguar të kujdesit, të specifikuar në nenin 18 të Ligjit për Barazi Gjinore, si pjesë e sistemit ekonomik, veçanërisht gjatë formulimit dhe zbatimit të politikave dhe masave makroekonomike në përgjigje të pandemive.

### **Sigurimi i likuiditetit afatshkurtër përmes kredive**

Statistikisht, bizneset në pronësi të grave kanë më shumë të ngjarë të jenë biznese të vogla në sektorët e shitjes me pakicë dhe shërbimeve, dhe këto biznese po shohin një rënie të papritur dhe të konsiderueshme të të ardhurave. Duke krijuar një alternativë të re të ripagimit, duke përfshirë shtyrjen e pagesave për kredi për një periudhë prej të paktën gjashtë muajsh, do të ishte më e dobishme pasi që kreditë biznesore shihen si një instrument kryesor i huadhënies që përdoret në industri të bazuara në shërbime të tilla si restorantet dhe shitjet me pakicë.

Ky material financohet plotësisht ose pjesërisht nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar për Zhvillim (Sida) dhe We Effect.

Përmbajtjet e kësaj analize nuk reflektojnë medoemos qëndrimet e Sida dhe We Effect.